Shtojca 1, miratuar me VKM nr. nr.653, datë 14.09.2016

| **Emërtimi i ligjit** | **Ligji është subjekt i konsultimit publik (Nëse jo pse)** | **Koordinatori për konsultimin publik** | **Forma e njoftimit** | **Palët e përfshira në konsultim** | **Forma e konsultimit (marrja e komenteve dhe rekomandimeve** | **Afati i dorëzimit të komenteve dhe rekomandimeve** | **Afati A ka patur zgjatje/ përsëritje** | **Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve** | **Raporti transparence në proçesin e vendimmarrjes** | **Shqyrtimi i ankesave nëse ka** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Projektligji “Policia e Burgjeve” | Projektligji në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit në portalin e “Rregjistrit elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” si dhe me kalimin e afatit të parashikuar në këtë ligj, projektligji ka qënë në proces konsutimi në datat 11 – 12 Prill 2019, tryeza konsultimi të organizuara pranë Ministrisë së Drejtësisë, për konsultimin e projektligjeve të sistemit | Specialist nga Drejtoria e Hartimit të Akteve | 1.Publikimi në portalin e “Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”<br>2.Email | Përfshirja në procesin e konsultimit, nëpërmjet rregjistrit elektronik, ishte gjithpërfshirës në të cilën jo vetëm institucionet shtetërore apo shoqëria civile por edhe qytetarët kishin mundësinë e dhënies së kontributit të tyre në përmirësimin e projektligjit për cështjet që mund të adresonin, por gjatë kohës së publikimit të projektligjit në portal për | Komentet dhe rekomandimet nga grupet e interesit apo shoqëria civile të cilët kanë qenë pjesëmarrës në tryezat e konsultimit të projektligjit janë përcjellë nëpërmjet postës elektronike si dhe me shkresë zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë. | Në zbatim të ligjit nr.146/2014 projektligji “Për Policinë e Burgjeve” i është nënshtruar procesit të konsultimit në portalin e “Rregjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” në datat 11.03.2019-08.04.2019, periudhë kjo në të cilën jo vetëm institucionet shtetërore, qytetarët por edhe përfaqësues nga shoqëria civile iu është dhënë mundësia për të paraqitur sugjerime dhe rekomandime në drejtim të përmirësimi të projektligjit. | Jo nuk patur zgjatje të afatit | Avokati i Popullit ka përcjellë komentet e mëposhtme:<br>1.Ne nenin 17 të projektligjit të zëvëndësohet termi “ka përparësi në” me “përfiton nga trajtimi financiar”<br>2. Po në drejtim të nenit 17 të të projektligjit të zëvëndësohet termi “privacion” me ndalesa<br>3.Diskutime ka patur dhe në lidhje me transferimin e punonjësit të policisë së burgjeve.Sipas Avokatit të Popullit duhet të jetë përcaktuar afati për të ofruar garanci. Mos përcaktimi i nje afati të arsyeshëm kohor në rastin e transferimit, mund të lërë shteg për abuzime, duke transferuar punonjës për t’i ndëshkuar ata ose për t’i detyruar të largohen nga detyra, për shkak të largësisë së | | Nga raporti i gjeneruar nga ky portal, projektligji është parë nga 85 (tetëdhjetë e pesë) vizitor, të cilët nuk kanë dhënë kontribut për këtë projektakt. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Penitenciar. | | | “Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, nuk është përcjell asnjë koment mbi përmbajtjen e projektligjit. | | Në datat 11 – 12 Prill 2019, janë zhvilluar tryeza konsultimi pranë Ministrisë së Drejtësisë, për konsultimin e projektligjit “Për Policinë e Burgjeve” ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga institucionet e pavarura si dhe nga organizatat jofitimprurëse përkatësisht:<br>1.Alba Jorganxhi (OSBE), 2.Skerdian Kurti (Pedagog), 3.Ardita Kolmarku (KSHSH), 4.Ermonela Xhafa (Avokati i Popullit), 4.Edlira Osmani (EURALIUS), 5.Gianluigi Hotole (ERALIUS) dhe 6.Ermira Shkurti (UNICEF) etj të cilët përcollën komentet e tyre në lidhje me projektligjin. | | vendbanimit me vendin e punës.<br><br>Përfaqësuesit e EURALIUS-it kanë përcjellë këto komente:<br>1. Termi acquis communautaire nuk përdoret në terminologjinë ligjore të BE, pasi Komunitetet Europiane u çbënë me krijimin e Bashkimit Europian.<br>2.CoE dhe rregullat e saj nuk formojnë pjesë të EU acquis. Në këto kushte, pavarësisht se Rec 2006 të Këshillit të Europës nuk janë të karakterit detyrues por referimi në to ndihmon dhe orienton në hartimin e një projektligji të përmirësuar në drejtim të funksionimit dhe organizimit të policisë së burgjeve. | | |